

VENDIM
Nr. 509, datë 17.7.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 551, DATË 18.6.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE
PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E LEJES PROFESIONALE PËR
VEPRIMTARITË STUDIMORE-PROJEKTUESE DHE ZBATUESE PËR
KËRKIMIN, PRODHIMIN, PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN, DEPOZITIMIN
DHE TREGTIMIN E LËNDËVE HIDROKARBURE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 5, dhe 115, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Personi juridik ose fizik, për të ushtruar veprimtarinë studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure, duhet ta ketë të regjistruar si objekt, në regjistrin tregtar, kryerjen e kësaj veprimtarie.”.

b) Pika 7 shfuqizohet;

c) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Personi juridik ose fizik, i regjistruar paraprakisht në regjistrin tregtar, që ushtron veprimtarinë studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure, duhet të ketë të punësuar specialistë, të cilët të jenë të pajisur me certifikatë, sipas kategorisë përkatëse, për veprimtari studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure.”.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama